

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

SHTATOR 2023

Shpërndarja e 'Certifikata mirënjohje' nga Ministri i Drejtësisë Z.Ulsi Manja, për Organizatat vendase dhe të huaja të shoqërisë civile, që kontribuojnë në Parandalimin e Krimeve të të Rinjëve dhe Ndhimën Juridike Falas.



Qendra e Ndhimës Juridike Parësore Elbasan, në datën 14.09.2023 ka pritur vizitën e gazetares austriake Znj. K.Piker, së bashku me përfaqësuesen e programit ADA(ADC in Albania), përfaqësuesen e UNDP Albania. Në këtë takim mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas, Z.E.Qirici.



Muaji Shtator - Tetor

Zhvillimi i aktiviteteve dhe sesioneve informuese për Dhunën në familje/abuzimin seksual dhe Trafikimin nga Qendrat e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore

Kavajë dhe Durrës

Në kuadër të muajit kundër "Dhunës në Familje", me datë 22.09.2023 nga ana e Qendrës së Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Kavajë dhe nga ana e Qendrës së Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Durrës është zhvilluar aktiviteti në Bashkinë Rrogozhinë, në Seksionin e Dhunës në Familje.



Lushnjë

Qendra e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 29.09.2023, mori pjesë në aktivitetin e iniciuar nga UNDP, në bashkëpunim me shërbimin social, me temë "Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje(MKR)"



Mat

Qendra e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Mat, në datën 07.09.2023 mori pjesë në takimin për evidentimin e faktorëve që shkaktojnë dhunë në familje. Takimi u realizua në ambientet e Bashkisë Burrel, me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Ministrisë së Shëndetësisë.

Vlorë

Qendra e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Vlorë, në datën 28.09.2023, zhvilloi aktivitetin me temë "Trafikimi, rëndësia e parandalimit të këtij fenomeni dhe trajtimit në kohë të pasojave të tij".



Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, në datën 13.09.2023 u ftua nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Lezhë për të marrë pjesë në takimin e organizuar në kuadër të Analizës së 3-të Mekanizmit të Koordinuar të Referimi për rastet e dhunës në familje, ku ishte e pranishme Ekspertja e deleguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. E.Jorgoni në një takim me antarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN).



Korçë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë, në datën 26.09.2023 në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social zhvilloi një aktivitet informues për dhunën në familje/abuzimin seksual dhe trafikimin.



Përmet

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Përmet, në datën 26.09.2023 zhvilloi një takim informues në ambientet e qendrës së fëmijëve me aftësi të vecanta dhe abuzimit ku pjesë e takimit ishin drejtoresha e qendrës, përgjegjësjë e dhunës në familje si dhe përfaqësuesja e shërbimit përmbartimor.



Gjirokastrë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë, më datë 29.09.2023, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues dhe promovues pranë IA Shkolla e Mesme " Pandeli Sotiri", Gjirokastrë, i cili konsistoi në informimin e kuadrit ligjor për viktimat e dhunës në familje/abuzimi seksual dhe trafikimi, bashkëpunimin ndërinstitucional, njohjen dhe përfitimin e shërbimeve ligjore falas.



Elbasan

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan zhvilloi 3 takime, në ambientet e shkollave Kostandin Kristoforidhi, Dhaskal Todri, Vasil Kamani, në kuadër të muajit Shtator-Tetor, si pjesë e sesionit informues për dhunën në familje/abuzimin seksual dhe trafikimin.



Shkodër

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër zhvilloi një takim me qytetart Z.S.Tahiri dhe zj.V.Sinanaj (bashkëjetues) të cilit ishin me referencën e Komisarariatit të Policisë, Malësi e Madhe.



Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës realizoi pranë ambienteve të Shërbimit Social, një takim informues në kuadër të muajit Shtator-Tetor si pjesë e sesionit informues për dhunën në familje /abuzimin seksual dhe trafikimin.





Tropojë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë në datën 21.09.2023, në kuadër të sesionit informues kundër dhunës në familje zhvilloi pranë Bashkisë Tropojë një takim me anëtarët e Mekanizmave të Kordinuar të Referimit të Rasteve .



Pukë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pukë, në kuadër të sesionit informues kundër dhunës në familje zhvilloi dy takime në bashkëpunim me Kordinatoret e Bashkise Pukë dhe Organizatat Jofitimprurëse.



Dibër



Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër, në datën 25.09.2023, në kuadër të sesionit informues kundër dhunës në familje zhvilloi një takim me nxënësit e gjimnazit Sehit Najdeni, Peshkopi.

Pogradec

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec, në datën 28.09.2023, në kuadër të sesionit informues kundër dhunës në familje organizoi në bashkëpunim me Psikologjen e Shkollës 9-vjecare "Kajo Karafili" Gështenjës, Pogradec, një takim ndërgjegjësues me temë *"Dhuna në familje dhe pasojat e saj, rëndësia e parandalimit të këtij fenomeni dhe institucionet ku duhet të drejtohemi"*.



Berat

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat, në datën 20.09.2023, zhvilloi një takim në fasonerinë "AFA 3 CALZATURA", në kuadër të muajit Shtator-Tetor, si pjesë e sesionit informues për dhunën në familje/abuzimin seksual dhe trafikimin. Në këtë takim ishin prezent përgjegjëset, drejtuesja e fasonerisë (shtetase italiane) dhe ekonomistja.

Aktivitete të tjera të zhvilluara gjatë muajit Shtator nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Korçë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë, me pjesëmarrjen e specilistes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas Zj. G.Nurçelli, zhvilloi dy aktivitete. Në datën 11.09.2023 aktivitet informues dhe promovues në zonën e Pazarit të vjetër dhe në datën 12.09.2023, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, në sallën e mbledhjeve të Bashkisë Korçë.



Berat

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat, në datën 08.09.2023 zhvilloi një takim për një bashkëpunim midis qendrave, me qëllim shkëmbim përvojash dhe referim të rasteve reciproke me organizatën Jofitimprurëse "Vatra".



Tropojë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë, në datën 13.09.2023 zhvilloi një takim informues me qytetarë përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar.



Gjirokastër

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër, në datën 01.09.2023 zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues pranë Zyrës së Postës (6001), Gjirokastër, ku ndodheshin persona të kategorisë së veçanta të ligjit, personat që përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale, pensionistët, etj.



Aktivitetet e tjera të zhvilluara gjatë muajit Shtator nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Kavajë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, në datën 06.09.2023 ka zhvilluar një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Sinaballaj, Rogozhinë dhe punonjësit e kësaj Njësie, me qëllimin e lidhjes së një ure bashkëpunimi midis dy institucioneve.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, në datën 26.09.2023, me pjesëmarrjen e specialistes znj.S.Qevani dhe Drejtoreshës së Ndihmës Juridike Dytësore znj. K.Poci, organizoi një takim me Drejtoreshën e Shërbimit Social, pranë Bashkisë Kavajë.



Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, në datën 19.09.2023 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga fondacioni 'Së Bashku', në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me tematikë "Mbrojtja nga diskriminimi".

Mat

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Mat, ka zhvilluar gjatë muajit shtator 12 aktivitete informuese dhe promovuese në disa nga shkollat 9 vjeçare dhe gjimnaze të qytetit të Matit, si dhe Njësitë kryesore administrative të qytetit Mat:

- Takim në shkollën 9-vjeçare, në shkollën "Ilija Qiqi"
- Takim në shkollën 9-vjeçare "31Korriku"
- Takim në shkollën "Mustafa Gjesta"
- Takim në shkollën "28 Nentori", Burrel
- Takim në shkollën e mesme "Pjeter Budi"
- Takim në shkollën e mesme të Bashkuar, Bruç
- Takim në shkollën e mesme "Shaban Çollaku" Klos
- Takim në shkollën 9-vjeçare "Hoxha Tahsin" Klos
- Takim në Njësinë administrative Ulëz.
- Takim në Njësinë Administrative Rukaj, në fshatin Bruç.
- Takim me Shoqatën 'Për mbrojtjen e personave me aftësi ndryshe' me seli në qytetin e Burrelit
- Takim informues dhe sensibilizues në Bashkinë Klos.

Vlorë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, në datën 28.09.2023 mori pjesë në Tryezen e Rrumbullakët, me temë "Komunitetet fetare përkrah institucioneve/organizatave, pjesë e Mekanizmit të Referimit të Dhunës në luftën kundër dhunës ndaj grave e vajzave"

Pukë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pukë, ka zhvilluar dy aktivitete informuese dhe promovuese, në qytetin e Pukës, një ndër to me qytetarë të Komunitetit Rom.



Korçë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë, në datën 28.09.2023, mori pjesë në takimin e Tryezës Teknike Antitrafik, në mjediset e Prefekturës, me tematikë parandalimin e trafikimit, masat e rehabilitimit dhe identifikimit të rasteve në nevojë.



Lushnjë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 13.09.2023 zhvilloi një takim me organizatën "Vatra", për një bashkëpunim midis qendrave, me qëllim shkëmbim përvojash dhe referim të rasteve reciproke.

Fier

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier, në datën 08.09.2023 mori pjesë në një takim, zhvilluar në ambientet e Bashkisë Fier, ku ishin prezent përfaqësues të UNDP, ZVAP Fier, Shërbimi Social, drejtoresha e DRAKPA Fier, Policia Fier, si dhe drejtues të Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Romano Kham, Qendra për Advokim Social, Qendra Murialdo, IRCA.



Fier

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier, në datën 04.09.2023 realizoi një takim me përfaqësuesen e Qendrës "Vatra" Vlorë, në ambientet e zyrës, ku pjesëmarrëse ishte dhe nëna e vajzës S.M., e cila është strehuar pranë qendrës "Vatra" në Vlorë, për rehabilitimin e saj dhe rikthimin në familje pasi ka qenë e trafikuar dhe shfrytëzuar për prostitucion.

